

Shqiptarët vazhdojnë të bashkëjetojnë me fantazinë

Intervistë e studiuesit të njohur të letërsisë shqipe, Robert Elsie, dhënë redaktorit të së përvajshme letrare artistike “Drita” të Shqipërisë

[FV]: Robert Elsie është një emër i njohur për lexuesit e gazetës tonë. Ju lutem, a mund ta informoni më gjerësisht lexuesin për disa nga botimet më të rëndësishme në fushën e studimit të letërsisë shqiptare?

[RE]: Më 1986 kam botuar një Nju Jork “Fjalorin e letërsisë shqipe” një lloj mikroenciklopedie të letërsisë shqiptare. Fjalori përfshin afërsisht 300 shkrimtarë, me të dhëna të plota biobibliografike; natyrisht duke qenë të pranishëm dhe shkrimtarët nga Kosova e ata arbëreshë. Mund ta them me krenari se ndonëse “Fjalor i letërsisë shqipe” nuk është i plotë, e tek tük mban fajësinë e ca pasaktësive të pashmangshme, prapë se prapë ai është i pari i llojit të vet.

Po në vitin 1986, përktheva dhe botova “Vargjet e lira” të Migjenit, këtë radhë në Gjermani. Jam recensent i letërsisë shqiptare në revistën amerikane “World Literature Today.” Kjo revistë botohet nga Universiteti i Oklahomës dhe është organi i parë i shtypit amerikan që botohet për kritikën letrare të letërsisë botërore.

Mund të përmend e një “Antologji e poezisë shqipe” në gjermanisht e kjo, të më besoni, nuk ka qenë gjë e lehtë sepse për fat të keq, një antologji e plotë e poezisë shqipe nuk është botuar ende edhe te ju. Ndërsa para dy muajve botova në Mynih historinë e letërsisë së sotme shqipe, një panoramë e gjerë studimore, që nga fillimet e shkrimit shqipe e deri tek shkrimtarët e rinj. Është pasqyra e parë e plotë mbi historinë e letërsisë shqipe, botuar në një vend perëndimor, ndoshta dhe në botë, e botuar në një gjuhë të huaj.

[FV]: Pse jeni joshur nga letërsia shqipe, në ç’rrethana?

[RE]: Studimet universitare i kam filluar si filolog, në Universitetin e Bonit, ku jam doktoruar në vitin 1978. Aso kohe pasioni im ishte indo-evropianishtja në përgjithësi, e keltishtja në veçanti. Por ja që më vonë lexova diçka për gjuhën shqipe. I çuditur mësova se në Gjermani kishte ekzistuar një bibliotekë e tërë studimesh për gjuhën shqipe, duke filluar nga Franc Bopi e duke vazhduar me emra të tjerë të mëdhenj. Më vonë vura re që, në qoftë se gjuha shqipe ishte një temë tërheqëse për linguistët gjermanë, nga ana tjetër letërsia shqipe nuk njihej fare. Bile, mund të them se letërsia shqipe ishte e vetmja letërsi evropiane ende e pazbuluar. Natyrisht, duke përjashtuar përkthimet e romaneve të Kadaresë. Dhe një kontinent i pazbuluar të josh më tepër për ta shkelur. Nuk duhen harruar këtu edhe përpjekjet e mia për të përkthyer. Përpara se të njihja letërsinë shqipe, kisha bërë disa sprova përkthimesh nga letërsitë e tjera. Njohja me letërsinë shqipe më premtonte edhe përkthime të reja prej saj.

[FV]: Sipas mendimit tuaj, çfarë do ta tërhiqte lexuesin e huaj nga korpusi i përgjithshëm i letërsisë sonë?

[RE]: Personalisht, mua më ka tërhequr poezia shqipe. Poezia duket se është një lloj veçorie e strukturës shpirtërore dhe psikike të shqiptarëve. Ndoshta edhe e ballkanasve në përgjithësi. Letërsia e juaj me duket më e fortë në poezi se në prozë. Unë mahnitem kur dëgjoji se si këtu edhe në Kosovë, poezia përfshin afër 50 për qind të botimeve të përgjithshme. E kjo ndodh kur në vendet e tjera poezia zor të kap pesë për qind të botimeve. Poezia shqipe, nga ana tjetër, jo vetëm që krijohet, por dhe lexohet. Ndoshta jeni ndër vendet e rralla që ende jetoni me poezi. Në Amerikë zor së mund të gjesh një njeri që të dijë poezi përmendsh, natyrisht duke përjashtuar poezitë që të detyron shkolla t'i mësosh që nxënës. Në Shqipëri kam takuar plot njerëz që dinë vargje përmendsh, e kjo më duket një lloj çudie e vërtetë.

Shqiptarët duket se ende bashkëjetojnë me fantazinë. E njoh mirë poezinë shqiptare dhe poetët shqiptarë që shruajnë në Kosovë. Është një poezi me një nivel shumë të lartë, me një përkujdesie për tingëllimin e fjalës, plot ironi dhe struktura të gjalla. Po të më pyeste ndonjë njeri adresat e letërsisë shqipe, do i thoja për poezinë, kërkojë edhe në Prishtinë edhe në Tiranë, për prozën moderne në Tiranë, për kritikën e mirëfilltë në Prishtinë, ndërsa për dramën ju lutem mos bëni pyetje!

[FV]: A mendoni se letërsia shqipe propagandohet mirë tek lexuesit e huaj?

[RE]: Mirë? Do thoja shumë keq! Më kujtohet para ca viteve kisha ardhur me ca gjermanë, anglezë e evropianë të tjerë në Shqipëri. Në mbrëmje në hotel bashkudhetarët e mi i gjeta duke lexuar ca libra të letërsisë shqipe, të përkthyer nga ju vetë, që ata i kishin blerë në Tiranë. Më mirë të mos i kishin lexuar, sepse krijuan një përfytyrim të tmerrshëm për letërsinë tuaj. Faji i përkthimit? Apo zgjedhja shumë e keqe? Ndoshta edhe njëra edhe tjetra. Sidoqoftë, u përpoqa mjaft t'ua mbushja mendjen se letërsia shqipe është diçka krejt tjetër.

[botuar në / published in: gazeta *Flaka e Vëllazërimit*, Shkup/Skopje, 22 shkurt/February 1991.]